



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Nr. i Dokumentit: 24.14.1-2017-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KËSHILLIT TË
KOSOVËS PËR TRASHËGIMI KULTURORE PËR VITIN E
PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017

Prishtinë, maj 2018

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Valbon Bytyqi, i cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Udhëheqësja e Auditimit Edona Abazi-Demolli, dhe Anëtares së ekipit Lindita Ajeti, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Faruk Rrahmani.

TABELA E PËRMBAJTJES


Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	10
4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	14
5 Qeverisja e mirë.....	15
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	17
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake.....	20
Shtojca III: Letërkonfirmimi	23

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 28/03/2018.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore.

Zyra Kombëtare e Auditimit e vlerëson bashkëpunimin e treguar nga menaxhmenti i lartë dhe stafi i Këshillit gjatë procesit të auditimit.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm


Opinion i pamodifikuar

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2017 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore



Përgjigja e Udhëheqësit Ekzekutiv

Udhëheqësi Ekzekutivi Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë rekomandimet e dhëna.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshinë ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë (tani e tutje Këshilli). Ne kemi analizuar veprimtarinë e Këshillit, se deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP).

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Gjithashtu merret parasysh edhe deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave (MF).

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar

Ne kemi audituar PFV-të e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin, Nr. 03/L-221, Nr. 04/L-116, Nr. 04/L-194 dhe Ligjin, Nr. 05/L-063), dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV

Udhëheqësi Ekzekutiv i Këshillit është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është

përgjegjës për kontrolle të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin, Nr. 03/L-221, Nr. 04/L-116, Nr. 04/L-194 dhe Ligjin, Nr. 05/L-063).

Kryetari i Bordit dhe Udhëheqësi Ekzekutiv i Këshillit janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Këshillit.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbuloj çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Këshilli kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin, Nr. 03/L-221, Nr. 04/L-116, Nr. 04/L-194 dhe Ligjin, Nr. 05/L-063);
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 01/2013 dhe 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve;
- Planin përfundimtar të Prokurimit; dhe
- Raportet për obligimet e papaguara.

Të gjitha kërkesat për raportim si në kontekst të PVF-ve ashtu edhe të raportimit të jashtëm ishin përmbushur me një cilësi të mirë dhe ne nuk kemi asnjë çështje për të ngritur.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime lidhur me PFV-të.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore, pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi shpenzimet janë të përshtatshme, megjithatë një sërë fushash kërkojnë përmirësim të mëtejshëm.

Në vitin 2017, Këshilli kishte një performancë jo të kënaqshme buxhetore sidomos te kategoria e mallrave dhe shërbimeve ku buxheti final ishte shpenzuar vetëm 53%. Po ashtu, këtë vit realizimi i buxhetit final ishte për 11% më i ulët se në vitin paraprak.

Mangësi ishin identifikuar edhe te menaxhimi i pasurive dhe menaxhimi i dosjeve të personelit të cilat kërkojnë përmirësim dhe një fokus më të madh nga menaxhmenti.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e tyre sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Burimet e Fondeve:	196,797	190,344	152,138	178,836	150,544
Granti i Qeverisë -Buxheti	196,797	190,344	152,138	178,836	150,544

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 6,453€ (5,453€ ishte reduktuar në mallra e shërbime dhe 1,000€ në shërbime komunale). Ky zvogëlim është në pajtim me vendimin e Qeverisë nr. 10/19, të datës 15/12/2017, dhe ka ardhur si pasojë e mos realizimeve të shpenzimeve nga ana e Këshillit sipas Planit të rrjedhës së parasë.

Në vitin 2017, Këshilli ka shpenzuar 80% të buxhetit final ose 152,138€, që tregon se realizimi i buxhetit të këtij viti është në nivel jo të kënaqshëm dhe më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

¹ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	196,797	190,344	152,138	178,836	150,544
Pagat dhe Mëditjet	108,829	108,829	108,338	91,801	83,977
Mallrat dhe Shërbimet	85,418	79,965	42,761	85,084	64,472
Shërbimet komunale	2,550	1,550	1,038	1,951	2,095

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

- Buxheti final në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve ishte shpenzuar vetëm 53%. Ky nivel i ulët i shpenzimeve ka ndodhë për faktin se gjatë periudhës tremujore gusht – tetor 2017, Këshilli ka funksionuar pa menaxhment, dhe të gjitha aktivitetet dhe shpenzimet e planifikuara janë stopuar për këtë tremujor; dhe
- Buxheti final në kategorinë e shërbimeve komunale ishte realizuar 67%. Arsye e këtij niveli është fakti se planifikimi i buxhetit ishte bërë duke llogaritur shpenzimet në objekt privat. Mirëpo në ndërkohë Këshilli kishte ndërruar objektin, duke kaluar nga ai privat në atë shtetëror. Prandaj shpenzimet e ujit dhe të rrymës nuk janë shpenzuar për këtë arsye.

Çështja 1 – Realizimi i ulët i buxhetit për mallra e shërbime

E gjetura Realizimi i buxhetit prej 53% tregon se kjo fushë ka qenë sfidë për Këshillin për këtë vit. Realizimit të ulët të shpenzimeve në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve i kishte paraprirë mungesa e vendimmarrjes pasi që organizata nuk kishte Udhëheqës Ekzekutiv për një periudhë tremujore (gusht – tetor), me ç’rast të gjitha aktivitetet kishin pauzuar.

Si pasojë e mungesës së vendimmarrjes pjesa më e madhe e shpenzimeve të planifikuara për udhëtime jashtë vendit dhe trajnimet e stafit nuk janë realizuar.

Rreziku Ekzekutimi i dobët i buxhetit, do të rezultojë me shfrytëzim joefikas të burimeve si dhe redukton efektivitetin e operacioneve dhe arritjen e objektivave të planifikuara të Këshillit.

Rekomandimi 1 Kryetari i Këshillit duhet të sigurojë menaxhim efikas të buxhetit. Bazuar në shkaqet e realizimit të ulët të buxhetit, të marrë veprime përmirësuese, ndërsa performanca buxhetore të monitorohet në baza të rregullta dhe të merren veprime kur është e nevojshme.

3.2 Pagat dhe shtesat

Pagat dhe shtesat paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga Ministria e Administratës Publike dhe MF. Sipas shënimeve të SIMFK-së, buxheti për kategorinë e pagave dhe mëditjeve ishte 108,829€, ndërsa realizimi i shpenzimeve ishte 108,338€.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.3 Menaxhimi i personelit

Numri i planifikuar i stafit ishte 16, kurse numri aktual në dhjetor të vitit 2017 ishte 13, përfshirë gjashtë punonjës në njësinë operative dhe shtatë anëtarë të Bordit përfshirë kryetarin, të cilët janë emëruar nga Kuvendi i Kosovës.

Çështja 2 - Dobësi në menaxhimin e dosjeve të personelit

E gjetura Nga vlerësimi i mirëmbajtjes së dosjeve të personelit, kemi vërejtur se ka nevojë për disa përmirësime të këtyre dosjeve, konform Rregullores 03/2011. Në të gjitha dosjet nuk kishte listë për përshkrimin e detyrave të punës, dhe mungonte kopja e dokumentit të identifikimit dhe e kartelës së llogarisë bankare. Kurse në dy raste nuk ishte bërë vlerësimi i stafit për vitin 2017.

Rreziku Mos përshkrimi i detyrave të punësuarve mund të krijoj paqartësi në përgjegjësitë që bartë secili prej tyre, përderisa moskryerja e vlerësimit për të punësuarit pamundëson identifikimin e fushave për përmirësim dhe zhvillimin e tyre, e që kjo mund të ketë efekt negativ në performancën e tyre dhe të organizatës në përgjithësi.

Rekomandimi 2 Kryetari i Këshillit duhet të sigurojë që të gjitha dosjet e personelit janë të plotësuara në përputhje me legjislacionin dhe të azhurnohen me kohë. Po ashtu, fokus i veçantë duhet t'i kushtohet vlerësimit të rregullt të stafit dhe përshkrimit të qartë të detyrave dhe përgjegjësiave për të gjithë punonjësit e organizatës.

3.4 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime, duke përfshirë shërbimet komunale në vitin 2017 ishte 81,515€. Prej tyre ishin shpenzuar 43,799€, ose 53%. Ne kemi rishikuar proceset e blerjes së mallrave apo shërbimeve të pranuar, duke përfshirë edhe procedurat e prokurimit. Nga këto testime, vlerësojmë se Këshilli kishte arritur të zbatojë kërkesat ligjore, qofshin financiare apo ato të prokurimit.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.5 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Vlera neto e pasurive kapitale të Këshillit e shpalosur në PFV ishte 6,810€. Kurse, pasuri jokapitale ishin 7,303€, dhe vlera e stoqeve ishte 3,083€.

Ne kemi rishikuar nëse procesi i regjistrimit dhe mënyra e mbajtjes së evidencave është në pajtueshmëri me kërkesat e rregullës së MF-Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore, procesin e inventarizimit, zhvlerësimin dhe ekzistencën fizike të pasurive.

Çështja 3 – Mos inventarizimi i pasurisë

E gjetura Sipas rregullores për menaxhimin e pasurive nr.02/2013, çdo organizatë buxhetore obligohet të bëjë inventarizimin e pasurive në fund të çdo viti fiskal. Inventarizimi bëhet me qëllim të vërtetimit të saktësisë, cilësisë dhe gjendjes fizike të pasurisë jo financiare. Këshilli për vitin 2017 nuk e kishte kryer inventarizimin e pasurive me të cilat posedon.

Rreziku Mos kryerja e inventarizimit të pasurisë rritë rrezikun e mungesës së informatave qoftë për saktësinë, cilësinë apo gjendjen fizike të pasurisë jo financiare. Kjo rrezikon që të mbahen pasuri në pasqyra financiare të cilat mund të mos ekzistojnë apo të jenë të dëmtuara apo të keqpërdorura.

Rekomandimi 3 Kryetari i Këshillit duhet të sigurojë kontroll efektive në menaxhimin e pasurive të saj përmes procesit të inventarizimit. Inventarizimi duhet të kryhet në fund të çdo viti fiskal dhe duhet të shërbej si mekanizëm për të konfirmuar gjendjen fizike, saktësinë, plotësinë dhe të krahasoj gjendjen me regjistrat e pasurive që i mbahen nga Këshilli.

3.6 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2017 ishte 454 €, prej tyre 370€ ishin obligime të papaguara nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, ndërsa 84€ për shërbime komunale. Këto dy fatura janë të pranuar gjatë muajit janar 2018, për shërbimet e pranuar për vitin 2017. Këshilli kishte raportuar në baza të rregullta mujore për obligimet e papaguara gjatë viti 2017.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e Këshillit për vitin 2016, ka rezultuar me gjashtë rekomandime kryesore. Edhe pse Këshilli kishte marrë veprime për t'i adresuar çështjet e ngritura në raport, ende mbetet sfidë zbatimi i plotë i tyre.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2017, tri rekomandime janë zbatuar, dy janë në proces të zbatimit, ndërkaq një nuk është zbatuar ende. Po ashtu, nga viti 2015 ishin bartur katër rekomandime prej të cilave, tri janë zbatuar dhe një mbetet ende i pa zbatuar.

Një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato shihni Shtojcën II.

Çështja 4 - Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve nga dy vitet paraprake

E gjetura Për rekomandimet e dhëna për vitin 2016, përkundër zotimit të Këshillit se do t'i zbatojnë të gjitha rekomandimet, ata nuk kishin përgatitur dhe dorëzuar as planin e veprimit, për zbatimin e rekomandimeve, kërkesë e nenit 23, paragrafi 5, i ligjit të ZKA-së.

Këshilli kishte bërë përmirësime në disa fusha në të cilat kemi dhënë rekomandime, mirëpo edhe me tutje mbeten dobësi në menaxhimin e proceseve operacionale. Rekomandimet e pazbatuara kanë të bëjnë me aprovimin e Rregullores së brendshme për kompensimin e punës në teren, e cila nuk është në pajtueshmëri me LMFPP-në dhe rregulloren nr.33/2012 (për të cilën nuk janë marrë masa për shfuqizimin e saj), si dhe mangësitë lidhur me regjistrin e pasurive.

Rreziku Mungesa planit të veprimit paraqet mungesën e gatishmërisë së menaxhmentit për të zbatuar rekomandimet e AP-së, ndërsa mos zbatimi i plotë i rekomandimeve rritë rrezikun e pranisë së vazhdueshme të mangësive të njëjta dhe mund të rezultojë me mos efikasitet të vazhdueshëm të kontrolleve, dhe vështirësi në përmbushjen e objektivave.

Rekomandimi 4 Kryetari i Këshillit duhet të siguroj fillimisht përgatitjen e një plan veprimi ku përcaktohen saktë afatet kohore për zbatimin e rekomandimeve të bëra nga AP, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme. Zbatimi duhet të monitorohet në vazhdimësi me qëllim të përmbushjes së rekomandimeve në plotësi.

5 Qeverisja e mirë

Hyrje

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA-së me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i një pjese të madhe të rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmer veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK-së nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i pyetësorëve të vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen MF-së.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentat tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Sfida kryesore me të cilën është përballë Këshilli gjatë këtij viti, e që lidhet me qeverisjen është menaxhimi i tij me Ushtrues Detyre të Udhëheqësit Ekzekutiv për një kohë të gjatë (duke përfshirë periudhën tremujore, e cila ka qenë pa Udhëheqës).

Këshilli ka bërë progres të lehtë në zbatimin e rekomandimeve nga kjo fushë. Megjithatë, Këshilli nuk e kishte hartuar regjistrin e rreziqeve, e ku mangësitë në identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve vështirësojnë arritjen e objektivave të tyre.

5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Sipas UA Nr. 23/2009 për themelimin dhe funksionimin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm (NJAB), Këshilli nuk i plotëson kriteret për themelimin e kësaj njësie.

Rekomandime

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranimit i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një proces të kontrollit të brendshëm për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, përkundër kësaj Këshilli gjatë vitit 2017 ishte ballafaquar me një sërë problemesh sa i përket çështjeve që reflektojnë në llogaridhënie dhe arritjes së objektivave të saj sipas planit të punës.

Çështja 5 – Sfidat në përmbushjen e detyrave sipas Planit Vjetor të Punës

- E gjetura** Në procesin e llogaridhënies dhe menaxhimit të rrezikut kemi identifikuar mangësitë si në vijim:
- Në vitin 2017 Këshilli ishte menaxhuar nga U.D të Udhëheqësit Ekzekutiv me rotacion prej tre muajsh nga tre zyrtar të brendshëm. Për më tutje, në periudhën gusht – tetor 2017, Këshilli kishte mbetur pa U.D. të Udhëheqësit Ekzekutiv, dhe të gjitha aktivitetet dhe shpenzimet e planifikuara sipas Planit të Punës janë pezulluar për këtë periudhë në mungesë të vendimmarrjes. Vlen të theksohet se në fillim të vitit 2018 ishte emëruar Udhëheqësi Ekzekutiv nga Bordi Drejtues i Këshillit; dhe
 - Këshilli nuk e kishte hartuar regjistrin e rreziqeve, konform rregullave të MFK-së. Si pasojë, Këshilli kishte vepruar pa analizuar dhe identifikuar rreziqet që mund të ballafaqohet organizata gjatë vitit.
- Rreziku** Mosplotësimi i pozitive kyçe brenda Këshillit, rezulton me reduktim të efektivitetit administrativ dhe arritjes së objektivave të tij. Po ashtu, mungesa e regjistrin të rreziqeve mund të pamundësojë reagimin me kohë ndaj rreziqeve me të cilat ballafaqohet organizata, qofshin ato nga mjedisi i brendshëm apo i jashtëm.
- Rekomandimi 5** Kryetari i Këshillit duhet të siguroj se është deleguar përgjegjësia për hartimin e regjistrin të rrezikut nëpër sektorët përkatës dhe njëkohësisht të sigurojë monitorim efektiv dhe raportim tremujor për zbatimin e kërkesave në këtë fushë.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2015	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara
2.4 Lista kontrolluese e vet-vlerësimit të MFK-së	Kryetari i Këshillit duhet të iniciojë hartimin e një strategjie gjithëpërfshirëse të institucionit, përcjellur me planin për menaxhimin e rreziqeve potenciale që pengojnë arritjen e objektivave të synuara. Po ashtu duhet të zbatohet një proces efikas për plotësimin e listës kontrolluese të vet-vlerësimit dhe të bëhet adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive.	Po		
2.5.1 Menaxhimi i rrezikut	Kryetari i Këshillit duhet të sigurojë se do të ndërmerren veprime konkrete për azhurnimin e vazhdueshëm të planit për menaxhimin e rrezikut, në mënyrë që të vendosen edhe masat e nevojshme për shmangien eventuale apo menaxhimin efektiv të rreziqeve të identifikuar.			Nuk janë marrë masa.
3.5.1 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)	Këshilli në bashkëpunim me Kuvendin e Kosovës si themelues duhet të rishikojnë Statutin aktual të KKTK-së për të përcaktuar nëse mbetet i përshtatshëm për rrethanat. Në bazë të analizave të rishikimit të vendoset në lidhje me pozitën aktuale të Kryetarit të Këshillit. Po ashtu në pajtim me dispozitat ligjore duhet të iniciohet procedura e emërimit/riemërimit të Udhëheqësit Ekzekutiv.	Po		
	Këshilli duhet të sigurojë që me rastin e angazhimit të punëtorëve, të aplikohet konkursi dhe konkurrenca, në mënyrë që vetëm persona adekuat dhe meritor caktohen në pozita të punës.	Po		

Komponenta e auditimit	Rekomandimet e dhëna në vitin 2016	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
2.1 Zbatimi i rekomandimeve	Kryetari i KKTK-së duhet të sigurojë se plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve është duke u monitoruar rregullisht dhe do të zbatohet në përputhje me afatet e përcaktuara kohore. Në fokus të jenë rekomandimet për fushat më të rëndësishme të menaxhimit financiar dhe kontrolleve.		Në proces të zbatimit- Një pjesë e rekomandimeve ende kanë mbetur të pazbatuara plotësisht.	
2.2 Pyetësi i Vet-vlerësimit	Kryetari i KKTK-së duhet të sigurojë miratimin e strategjisë gjithëpërfshirëse institucionale. Të bëjë rishikim adekuat plotësisht të listës kontrolluese të vet-vlerësimit, që të adresojë fushat me dobësi në mënyrë reale. Plotësimi i përgjigjeve të bëhet me të gjitha detajet e kërkuara nga pyetësi, dhe të mbështetet me dokumentacionin përkatës. Gjithashtu, KKTK duhet të krijoj mekanizëm që do të zbuste ekspozimin ndaj rreziqeve.		Në proces të zbatimit - për vitin 2017 nuk ishte hartuar ky regjistër. Mbetet të vlerësohet hartimi për vitin 2018.	
3.1.1 Pagat dhe Mëditjet	Kryetari i KKTK-së duhet të sigurohet që pozita e Udhëheqësit Ekzekutiv të plotësohet me kontratë të rregullt të punës dhe në pajtim me dispozitat ligjore.	Po, në janar 2018		
	Kryetari i KKTK-së duhet të sigurojë që angazhimi i punëtorëve, të bëhet mbi bazën e kriterëve të qarta dhe të dokumentuara në një proces transparent dhe konkurrues i cili siguron angazhimin e personave me meritë.	Po		
3.1.2 Mallrat dhe Shërbimet	Kryetari i KKTK-së të sigurohet që kërkesat buxhetore të jenë sa më reale dhe se shpenzimi i buxhetit të jetë në harmoni të plotë me planin e miratuar të shpenzimeve. Çdo ndryshim i planit duhet të jetë në pajtim me rregullat financiare. Zyrtari Kryesor Administrativ duhet të sigurojë që buxheti të menaxhohet/shpenzohet në mënyrë ekonomike dhe efikase.	Po		

	Kryetari i KKTK-së të siguroj që rregullorja e KKTK-së të jetë në harmoni me rregullat e përgjithshme, respektivisht në harmoni me rregulloren nr. 33/2012 për shtesat në pagë dhe kompensime të tjera të nëpunësve civilë. Po ashtu me rastin e pagesës së kompensimeve duhet të sigurohen raporte për secilin zyrtar për të dëshmuar ditët e angazhimit/kryerjes së detyrave në teren			Nuk janë marrë masa.
--	---	--	--	----------------------

Shtojca III: Letërkonfirmimi



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo

Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore
Savet Kosova za Kulturno Nasledje / Kosovo Council for the Cultural Heritage

RE PUBLIKË E KOSOVËS REPUBLICA OF KOSOVO			
KËSHILLI I KOSOVËS PËR TRASHËGIMI KULTURORE			
SAVETI KOSOVA ZA KULTURNO NASLEDJE			
KOSOVO COUNCIL FOR CULTURAL HERITAGE			
Titulli / Titulli Emri / Ime / Ime / Prezime	03-05	8	1
Titulli / Titulli Emri / Ime / Ime / Prezime	28/18		

LETËR E KONFIRMIMIT


Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2017 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017 (në tekstin e mëtejme "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.


z. Isuf Koci, udhëheqës ekzekutiv
Data: 03.05.2018, Prishtinë